



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtueshmërisë

PROKURIMI DHE MENAXHIMI I KONTRATAVE NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR VITIN 2023

Prishtinë, korrik 2024

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik kryen auditime vjetore financiare dhe pajtueshmërisë të detyrueshme me ligj dhe auditime të performancës.

ZKA përmes auditimeve ofron informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do të shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ne përmes raporteve të auditimit kemi ofruar një pamje të qartë se si qeveria dhe institucionet publike kanë menaxhuar me shpenzimet dhe të ardhurat, pasurinë publike dhe qeverisjen në nivel të vendit.

Ne kemi vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përdorimin e drejtë të burimeve dhe sistemeve tjera në Ministrinë e Shëndetësisë.

Fushë me rëndësi të cilës Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje çdo vit, është ajo e prokurimit publik, kjo duke pasur parasysh që është ndër fushat kryesore të shpenzimeve. Këto auditime kanë rol të rëndësishëm me ndikim që të rritet transparenca dhe efikasiteti në shpenzimet publike si dhe me qëllim që të rritet edhe vlera për parane e shpenzuar përmes prokurimit.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000). Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportin të auditimit “Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë” në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Zukë Zuka, i cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Përbërja e ekipit të auditimit:

Faruk Rrahmani, Drejtor i departamentit të auditimit;

Kreshnike Haziri, Udhëheqëse e ekipit;

Luljeta Ajazi, Anëtare e ekipit; dhe

Antigona Çitaku, Anëtare e ekipit.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhja ekzekutive	1
1. Hyrje	3
2. Korniza ligjore, objektiva dhe fushëveprimi i auditimit	4
3. Gjetjet e auditimit.....	7
4. Konkluzionet	15
5. Rekomandimet.....	17

Lista e shkurtesave

ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
AKPPM	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
AK	Autoriteti Kontraktues
QKTGJK	Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës
QKMF	Qendra Komunale për Mjekësi Familjare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik
OE	Operatori Ekonomik
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ISSH	Instituti Special i Shtimes
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor

Përmbledhja ekzekutive

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë me temën "Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2023". Objektivi e këtij auditimi është të vlerësojmë nëse vendimet e menaxhmentit dhe menaxhimi i proceseve të prokurimit (blerjeve) përfshirë edhe përmbushjen e kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë janë kryer në pajtueshmëri me kornizën ligjore, rregullat e prokurimit dhe aktet tjera relevante.

Proceset e blerjeve me prokurim kryesisht janë të fokusuar në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe në Investime Kapitale. Buxheti i vitit 2023 për MSH-në për këto dy kategori ishte 60,965,938€ përderisa ishin shpenzuar 27,262,221€ apo 44%. Nga aspekti i fondeve një pjesë e mjeteve (rreth 9 mil€) kanë qenë nga klauzola e investimeve për projektet për covid 19 të cilat nuk kanë mundur të shpenzohen.

Auditimi është fokusuar nëse proceset e prokurimit nga planifikimi e deri te lidhja e kontratave / anulimi i aktiviteteve ishin menaxhuar në harmoni me rregullat e prokurimit. Po ashtu, kemi vlerësuar edhe monitorimin dhe menaxhimin e kontratave nëse ato po përmbushen konform marrëveshjeve kontraktuale.

Konkluzioni i auditimit është se Ministria nuk ka arritur që një numër të rëndësishëm të proceseve të prokurimit që ishin planifikuar dhe inicuar t'i përfundojë me kontrata të nënshkruara. Realizimi i ulët i planit të prokurimit kishte një ndikim të theksuar edhe në nivelin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe furnizimeve me paisje mjekësore e barna (niveli ishte nën 50% të buxhetit të Ministrisë).

Mungesa e analizave me kohë, para procesit të tenderimit dhe kontrollet e dobëta gjatë procesit duke mos vepruar në fazat e hershme të tenderimit, ka rezultuar në mos nënshkrim të kontratave nga menaxhmenti. Kjo situatë ka ndikuar që proceset të ritenderohen dhe AK të mos i arrijë objektivat e saj në vitin aktual. Pasojat e mos realizimit të këtyre aktiviteteve kishin efekt në funksionimin e shërbimeve shëndetësore.

Proceset e vlerësimit në raste të caktuara nuk kishin arritur të identifikojnë gabimet në përlllogaritje të vlerës së ofertës dhe gjatë zbatimit të tyre ishte paraqitur nevoja për amandamentimin e tyre.

Monitorimi i kontratave ka shfaqur sfidat në lidhje me vonesat në përmbushjen e kontratave / aneks kontratave, dhe mos aplikim të platformës të e-Prokurimi për menaxhim të kontratave. Si rezultat i vonesave në hartimin e projektit të Klinikës Emergjente në QKUK ishte shtyrë afati për tenderin e ndërtimit, një projekt i rëndësishëm dhe rrjedhimisht një pjesë e fondeve kishin mbetur të pashpenzuara në vitin 2023.

Gjetjet e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e planifikimit, zhvillimit të prokurimit dhe monitorimit të kontratave nga Ministria e Shëndetësisë kërkojnë përmirësim të

menjëhershëm dhe për këtë janë dhënë pesë (5) rekomandime. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Me qëllim të përmirësimeve të mundshme ne rekomandojmë që proceset e planifikuara të aktiviteteve të prokurimit duhet të jenë të analizuara mirë dhe me informata të nevojshme për të parandaluar mundësinë që aktivitetet të jenë të pasuksesshme. Po ashtu, kontrollet nga menaxhmenti i proceseve të prokurimit duhet të vendosen në faza të hershme në mënyrë që të parandalohet dështimi për nënshkrimin e kontratave.

Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve të kontratave që kontratat po përmbushen sipas afateve të parapara duke aplikuar edhe penalet kur ato nuk realizohen sipas afateve dhe për menaxhimin e kontratave aplikohet platforma e e-prokurimit me qëllim të informimit dhe mbikqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti.

1. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me planifikimin, tenderimin dhe menaxhimin e kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe agjencitë e saj vartëse (Agjencia e Kosovës për Produkteve dhe Pajisje Medicinale, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut) të Kosovës për vitin 2023.

Qëllimi i prokurimit publik është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen nga autoritetet kontraktuese. Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të tyre shpenzohet përmes aktiviteteve të prokurimit publik.

Ministria e Shëndetësisë është autoritet kontraktues që zbaton Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (tani e tutje LPP) për aktivitetet e saj të prokurimit në bazë të nenit 2, par. 1 në lidhje me nenin 4, par. 1.13. Është përgjegjësi e menaxhmerit të prokurimit në kuadër të MSH-së që të përgadisë dhe të zhvilloj procesin e prokurimit sipas kërkesave të-LPPsë, dhe rregulloreve tjera sekondare për prokurimin publik.

Sipas nenit 4 të Ligjit për Kontrollin e brendshëm të financave publike, Ministri ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen e menaxhimit financiar dhe kontrollit të subjektit, dhe për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, politikave, strategjive, programeve, aktiviteteve dhe proceseve që ndërliken me zbatimin e tyre.

Gjatë periudhës së audituar MSh dhe agjencitë e saj vartëse kishin nënshkruar 263 kontrata publike me vlerë prej 22,147,977€, nga të cilat 5 kontrata në vlerë 379,571€ ishin lidhur me procedurë të negociuar pa publikim sipas nenit 35 të LPP-së, ndërsa të tjerat ishin zhvilluar me procedurave të hapura.

Proceset e blerjeve me prokurim kryesisht janë të fokusuara në kategorinë Mallra dhe Shërbime dhe në Investime Kapitale. Buxheti final i vitit 2023 për MSh-në për këto dy kategori ishte 60,965,939€ përderisa ishin shpenzuar 27,262,221€ apo 44% e buxhetit.

2. Korniza ligjore, objektiva dhe fushëveprimi i auditimit

2.1. Korniza ligjore

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) kryen auditimet në pajtuesmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe praktikave të mira. ZKA ka mandat kushtetues dhe ligjor, për t'i audituar programet dhe projektet e menaxhuara nga organizatat buxhetore dhe të financuara nga Buxheti i Kosovës. Auditimi kryhet në bazë të nenit 21, paragrafi 2 të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe ZKA të Republikës së Kosovës. Në bazë të ligjit të ZKA-së, të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në web-faqen zyrtare.

Auditimi është kryer në përputhje me SNISA 100 – Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, SNISA 400 – Parimet themelore të auditimit të pajtueshmërisë, dhe SNISA 4000 – Standardet e auditimit të pajtueshmërisë, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë. ZKA është e pavarur nga subjektet nën auditim. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e konkluzioneve të auditimit.

2.2. Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është të:

- Vlerësojmë nëse vendimet e menaxhmentit dhe menaxhimi i proceseve të prokurimit (blerjeve) përfshirë edhe përmbushjen e kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë janë kryer në pajtuesmëri me rregullat e prokurimit dhe aktet tjera relevante; dhe
- Nxjerrim konkluzione të qarta për identifikimin e dobësive dhe fushave për përmirësim të cilat do ta mbështesin Ministrinë në përmbushjen e objektivave të saj përmes kontratave për furnizim, shërbime dhe kryerje të punëve.

2.3. Fushëveprimi i auditimit

Subjekti i auditimit është Ministria e Shëndetësisë së bashku me tri Agjencitë ekzekutive të saj: Agjencia e Kosovës për Produkteve dhe Pajisje Medicinale (AKPPM), Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShPK) dhe Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut të Kosovës (QKTGJK).

Auditimi përfshinë periudhën nga 01 janari deri më 31 dhjetor 2023. Ky auditim përfshinë kontratat e nënshkruara të prokurimit në vitin 2023, duke përfshirë procesin e planifikimit në përgjithësi, procedurat

e prokurimit, menaxhimin e kontratës dhe masat që janë ndërmarrë nga Ministria e Shëndetësisë për t'u siguruar që ato kanë qenë efikase deri në arritjen e qëllimit të tyre.

Fushëveprimi i auditimit përfshin aktivitetet e prokurimit publik duke mbuluar tre nënproceset e veçanta të mëposhtme:

1. Përgatitja e proceseve të prokurimit (procesi nga përgatitja e planifikimit të prokurimit deri në publikimin e njoftimit të kontratës);
2. Proceset e tenderimit (procesi nga përgatitja e dosjes së tenderit deri në nënshkrimin e kontratës); dhe
3. Menaxhimi i kontratave (procesi i administrimit dhe ekzekutimit të kontratave).

Për të dhënë konkluzione të sakta do të verifikohet nëse aprovimet janë bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik dhe legjislacionit sekondarë. Auditimi do të mbuloj edhe pjesën e menaxhimit financiar të tyre siç janë pranimi i mallit/punëve, dhe kryerja e pagesave brenda afateve kohore për projektet e kontraktuara.

2.4. Mostrimi - Për qëllime të përmbushjes së auditimit është aplikuar çasja e mëposhtme e mostrimit:

1. Për nënprocesin "Planifikimi i prokurimit", nuk është aplikuar mostrim pasi që i tërë procesi i planifikimit dhe dokumentet relevante janë rishikuar për tërë periudhën e auditimit; dhe
2. Për nënproceset "Procedurat e tenderimit" dhe "Menaxhimi i kontratave" është aplikuar mostrimi jo statistikor sipas gjykimit profesional ku nga 263 kontrata të nënshkruara, në vlerë 22,147,966€ janë përzgjedhur për testim 40 prej tyre me vlerë 18,647,286€, apo 84 % e popullacionit. Poashtu, janë testuar edhe tri (3) procedura të anulimeve të prokurimit.

2.5. Kriteret e auditimit - Për përmbushjen e objektivës së auditimit janë aplikuar kriteret e auditimit për secilin nga tre nënproceset e audituara nga aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092;
- Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Udhëzues nr. 001/2023 për Prokurimin Publik;

- Formularër standard të KRPP për çështjet e prokurimit;
- Procedurat e brendshme të aplikuara nga Ministria e Shëndetësisë; dhe
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Për të verifikuar mbarëvajtjen e proceseve dhe zbatimit të tyre kemi vendosur kriteret si në vijim:

- Nëse planifikimi i prokurimit është në përputhje me afatet, nevojat reale dhe ndarjet buxhetore të parapara për Ministrinë;
- Nëse njoftimi paraprak është aplikuar në rastin e kontratave të pritura me vlerë të madhe;
- Nëse anulimit i aktiviteteve prokurimit ishte në përputhje me rregullat e prokurimit;
- Nëse sistemi e- prokurimi është aplikuar në të gjithë hapat e procesit deri te realizimi i plotë i kontratave;
- Nëse kriteret dhe specifikimet teknike ishin të qarta dhe jo favorizuese duke ofruar edhe sqarimet e nevojshme në proces;
- Nëse proceset e vlerësimit po kryhen nga personeli me ekspertizë dhe përputhje me kriteret në dosje të tenderit; dhe
- Nëse menaxhimi dhe përmbushja e kontratave po kryhet sipas kushteve, kriterëve dhe specifikave të kontraktuara.

3. Gjetjet e auditimit

Mangësitë e identifikuara në procesin e planifikimit, tenderimit dhe menaxhimit të kontratave pasqyrohen përmes gjetjeve të auditimit të cilat bazohen në analizimin e dokumenteve relevante. Në vijim shpalosim çështjet e identifikuara të çdo fazë.

3.1. Planifikimi dhe përgatitja e proceseve të prokurimit

Kjo fazë përfshinë hapat që autoriteti kontraktues duhet t'i ndërmerr në mënyrë që të hartohet një plan i mirë i prokurimit e deri të publikimi i njoftimit të kontratës.

Bazuar në nenin 8 të LPP-së, autoriteti kontraktues është përgjegjës për përgatitjen e planifikimit të prokurimit që identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon të prokurojë gjatë vitit fiskal. Më tej, ky proces është specifikuar në Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Në këtë fazë ne identifikuam mangësitë si në vijim:

Çështja 1 - Mangësitë në planifikimin e prokurimit dhe efektet e tyre

Rregullorja nr. 001/2022 për prokurimin publik, në neni 5 pikën 5.10 thekson që për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit, zyrtari i prokurimit do të bashkëpunojë ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera dhe të diskutojë kërkesat e tyre për prokurim dhe buxhetin në disponueshmëri për vitin e ardhshëm dhe do të vendos cilët artikuj të përfshihen në planifikimin e prokurimit. Ndërsa sipas nenit 13 pikës 13.1 vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të paralogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Paralogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar. Në parashikimin e vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim. Po ashtu neni 19 pika 19.14 thekson se specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues. Mangësitë në procesin e planifikimit ishin:

- Proceset e prokurimit për projekte kapitale të vitit 2023 kishin filluar kryesisht me vonesa për shkak që përgatitjet e duhura nga Ministria nuk ishin kryer me kohë (si projektet ekzekutive me mangësi të theksuara dhe nevoja për përmirësimin e tyre, mungesa e projektit dhe mungesa e studimit të fizibilitetit) për nisjen e aktivitetit të prokurimit. Po ashtu, disa nga këto aktivitete të prokurimit ishin vonuar edhe më shumë si rezultat i ankesave në OSHP nga ana e OE duke e bartur fillimin e këtyre proceseve të prokurimit në vitin 2024.

Prokurimet e planifikuara për projektet kapitale të cilat nuk kishin rezultuar me kontrata në vitin 2023 janë si në vijim:

1. Prokurimi për ndërtimin e QKMF-së në Drenas me buxhet prej 2,110,000€, ishte nisur me vonesë për shkak të mangësive në projekt (ndryshime dhe plotësime të shumta deri sa është finalizuar projekti) dhe më pas vonesat tjera ishin si pasojë e ankesave në OSHP;
2. Prokurimi për ndërtimin e klinikës emergjente në QKUK me buxhet prej 15,810,042€, nuk ishte inicuar fare në vitin 2023 për shkak se hartimi i projektit ekzekutiv kishte përfunduar me një vonesë prej rreth 5 muajve. (projekti duhej të ishte gati sipas kontratës në qershor kurse është kryer në nëntor 2023), duke e pamundësuar fillimin e aktivitetit në 2023;
3. Prokurimi për ndërtimin e objektit të Instituti Special të Shtimes me buxhet prej 8,000,000€ nuk kishte filluar për shkak që nuk kishte projekt dhe fillimisht Ministria kishte shpallur Konkurs për projektim por që as projekti nuk ishte hartuar gjatë vitit 2023;
4. Prokurimet për blerjen e licensave të VMWARE për Sistemi Informativ Shëndetësorë me buxhet prej 600,000€ dhe "Sistemi PACKS për SISH" me buxhet 1,350,000€ në mungesë të studimit të fizibilitetit ishin bartur në fund të vitit 2023 apo në fillim të vitit 2024. Kishte edhe prokurime për projekte tjera, furnizime e shërbime që nuk ishin finalizuar me kontrata për shkak të ankesave në OSHP dhe vendimit për anulim apo rivlerësim të aktivitetit nga ana e OSHP-së.

- Një numër prej 35 procedurave që kishin të bënin kryesisht me furnizime me pajisje mjekësore dhe barna (vlera 4,569,358€) ishin anuluar nga vetë Ministria për shkak të mungesës së ofertave apo për faktin që ofertat ishin të papërgjegjshme. Po ashtu, kishte edhe raste kur anulimet ishin nga fakti që ofertat tejkalonin në mënyrë substanciale buxhetin e planifikuar për këto furnizime (psh Lot 78 Phytomenadione, Lot 8 Chloropyramine hydrochloride 18 - 20g 1% Pomadë), e që vërehet që nuk ishin bërë paraprakisht analizat e duhura të çmimeve reale të tregut nga ana e Ministrisë.
- Ndarja në shumë Llot-e¹ e aktivitetit të prokurimit për "Furnizim me pajisje mjekësore, instrumente mjekësore për njësitë organizative të QKUK-së" në vlerë të parashikuar 1,920,000€ nuk kishte rezultuar të jetë shumë efiçente. Ndarja në shumë Llot-e e kishte tejzgjatur aktivitetin e prokurimit nga muaji maj deri në shtator, për shkak të pyetjeve/kërkesave shtesë nga operatët qoftë vetëm për një Llot, duke i shtyrë proceset për të gjitha Llotet. Nga 34 Llot-et e këtij aktiviteti me kontratë kishin rezultuar vetëm dhjetë (10) Lote-e dhe 24 ishin anuluar. Anulimet kishin ndodhur kryesisht për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme (sipas profesionistëve shëndetësor specifikat teknike dhe administrative ishin jo të duhura dhe në ritenderimin e këtyre Llot-eve ato duhet të rishikohen).

1 Fillimisht njoftimi për kontratë ishte bërë për 31 LOT-e dhe pas rekomandimeve të profesionistëve të fushës përmes formularit standard për korigjim, i njëjti është ndarë në 34 LOT-e

Përgatitjet jo të duhura të proceseve të prokurimit nga ana e Ministrisë dhe ankesat e OE-ve në OSHP ishin shkaktarët kryesor që kishin ndikuar në mos realizimin e planit të prokurimit dhe rrjedhimisht edhe nivelin e ulët të shpenzimeve (rreth 50% e buxhetit) si për projekte kapitale ashtu edhe për furnizimet me paisje mjekësore/ barna. Vonesat në lidhjen e kontratave për furnizime me paisje dhe barna ka ndikuar që pacientët të mos jenë të furnizuar me këto shërbime në kohën kur ata kanë nevojë.

Çështja 2 - Mungesa e njoftimit paraprak

Sipas nenit 39 të LPP-së, kur një AK ka për qëllim dhënien, gjatë periudhës së ardhshme 12 mujore të një ose më shumë kontratave të furnizimit, të shërbimeve apo të punëve, që vetëm ose bashkë, kanë një vlerë të parashikuar prej 500,000€ e më tepër, AK duhet të përgatisë njoftimin paraprak.

Njoftimi paraprak është ndihmesë në transparencë dhe është në të mirë të Operatorëve Ekonomik që të përgatiten dhe njoftohen për prokurimet e mundshme që do t'i zhvilloj AK. Po ashtu, kjo i mundëson AK-ve të zbatojnë afatet e shkurtuara pa pasur nevojë për aprovim të procedurave të përshpejtuara.

QKKTGJ kishte planifikuar dy kontrata të mëdha furnizimi si "Furnizim me Mikrokartela dhe Serume për grupe të gjakut" në vlerë 689,913€ dhe "Furnizim me qese të gjakut" me vlerë 962,258€, dhe për të njejtat nuk kishte përgatitur dhe publikuar njoftimin paraprak.

Mungesa e njoftimit paraprak nuk përkon me rregullat e prokurimit publik dhe njëkohsisht e ulë edhe transparencën për operatorët ekonomik që të njoftohen dhe përgatiten në kohë reale për prokurimet e mundshme. Po ashtu, kjo ndikon edhe në kufizimin e Ministrisë që të aplikojë afatet e shkurtuara të ofertimit pa pasur nevojë për aprovim.

3.2. Procedurat e tenderimit

Ky aktivitet përfshinë hapat që Autoriteti kontraktues duhet t'i ndërmerr për zgjedhjen e OE-ve më të përshtatshëm për furnizim me mallra & shërbime dhe ekzekutim të projekteve kapitale. Mangësitë e vërejtura në këtë aktivitet janë si më poshtë.

Çështja 3 - Kontrolle jo efektive të ministrisë në parandalimin e parregullsive në prokurim

Sipas nenit 7 të LPP-së pikës 3, Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

LPP në nenin 26, pikën 2 thekson se përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik. Nënshkrimet e përcaktuara sipas këtij neni, konfirmojnë dhe pranojnë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë. Kontratat që nuk nënshkruhen në pajtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni janë të pazbatueshme.

Gjatë vitit 2023, tri procese të tenderimit, ishin anuluar në fazën e nënshkrimit të kontratave, ndonëse procesi kishte kaluar të gjitha fazat e prokurimit. Anulimi ka ndodhur si pasojë e kontrolleve jo të mira gjatë gjithë procesit të prokurimit dhe si pasojë Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) nuk ka nënshkruar kontratat. I njëjti është përgjegjës të konfirmojë dhe pranojë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe vërtetojë se kontrata është në pajtim të plotë me ligjin e prokurimit.

Parregullsitë sipas menaxhmentit kishin të bënin me kriteret favorizuese të vendosura, specifikime teknike kufizuese të panevojshme, çmimet jo të arsyeshme apo edhe me autorizime të prodhuesve që ishin anuluar. Këto procese të prokurimit kishin arritur deri te hapi i njoftimit për dhënie të kontratës në platformën elektronike e-prokurimi dhe ishin nënshkruar nga menaxheri i prokurimit, megjithatë, parregullsitë ishin vërejtur në fund të procesit.

Prokurimet e anuluar kanë të bëjnë me:

- “Mirëmbajtja e 70% të HW të SISH-it për Institucionet Shëndetësore” në vlerë 715,999€;
- “Furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK” në vlerë 165,180€; dhe
- “Furnizim me produkte specifike dhe insulina analoge nga Lista Esenciale Llot 1 dhe Llot 2” në vlerë 838,281€.

Te këto tri aktivitete të prokurimit janë ndjekur procedurat si në vijim:

- a. Zyrtari Autorizues ka autorizuar Zyrtarin e Prokurimit që të inicojë aktivitetin e propozuar të prokurimit bazuar në deklaratën e ofruar të nevojave dhe përcaktimin e disponueshmërisë së fondeve, të nënshkruar nga ZKA dhe ZKF sipas nenit 22, paragrafi 2 i LPP-së.
- b. AK-ja ka përgatitur dosjen e tenderit duke përdorur formularin standard B05, duke ofruar të gjitha informatat e detyrueshme në përputhje me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të LPP-së.
- c. Specifikimet teknike janë përgatitur në përputhje me të gjitha kërkesat e nenit 28 të LPP-së.
- d. AK-ja ka përgatitur një Njoftim Kontrate në gjuhën shqipe dhe angleze në mënyrë identike sipas kërkesës për kontrata me vlerë të madhe sipas nenit 13, par. 2 të LPP-së dhe ka dorëzuar në KRPP të gjitha versionet gjuhësore, në bazë të nenit 40 të LPP-së.
- e. AK-ja kishte deklaruar kriteret e përzgjedhjes në njoftimin e kontratës që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë për t'u konsideruar të kualifikuar si dhe kriteret e dhënies si për shembull "çmimi më i ulët" sipas kërkesave të neneve 51 – 52 të LPP-së.
- f. Afatet kohore për dorëzimin e ofertave janë llogaritur sipas kërkesave të neneve 44-47 të LPP-së.
- g. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka emëruar Komisionin e Hapjes me 3 anëtarë sipas nenit 34 të Rregullores 001/2022. Tenderët janë hapur në kohën dhe vendin e përcaktuar në njoftimin e kontratës dhe ka procesverbal nga hapja sipas nenit 58, par. 3 të LPP-së të cilat u janë dërguar edhe të gjithë tenderuesve.
- h. AK-ja ka krijuar një Komision Vlerësimi për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave sipas kërkesave të nenit 59 të LPP-së dhe sipas kërkesave të nenit 39 të Rregullores. Të gjithë anëtarët e komisionit kanë nënshkruar Deklaratat nën betim sipas nenit 39.3 të Rregullores 001/2022.

Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar ofertat e paraqitura dhe votimi është dokumentuar në procesverbal. Për punën e tij, Komisioni i ka dorëzuar menaxherit të prokurimit një raport me rekomandime dhe një deklaratë të arsyeve që mbështesin atë rekomandim, sipas nenit 39.10 të Rregullores 001/2022.

Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka pranuar rekomandimin e komisionit, duke i shpjeguar me shkrim arsyet dhe ka marrë vendim përfundimtar për dhënien e kontratës

Sipas kërkesave të nenit 26, paragrafi 2 i LPP-së, përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit, kontratat me vlerë të madhe duhet të nënshkruhen edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri. Sekretari i Përgjithshëm nuk konfirmoi dhe nënshkroi kontratat, kështu që kontratat u bënë të pazbatueshme.

Mungesa e analizave të duhura dhe me kohë para procesit të tenderimit (të çmimeve të tregut, specifikave teknike dhe kritereve të tenderit), kontrollet e pamjaftueshme gjatë procesit të prokurimit, përkatësisht në fund të procesit nuk japin siguri se aktivitetet janë menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive. Ministria nuk ka arritur të ushtrojë kontrolle të hershme për të shmangur parregullsitë në proces dhe si pasojë kemi anulime të kontratave duke e ndikuar mbarëvajtjen e funksionimit të sektorit të shëndetësisë.

Çështja 4 - Dobësi në dosjet e tenderit lidhur me kërkesat e pranueshmërisë

LPP në nenin 65 paragrafi 3 dhe nën paragrafët 3.1-3.6 thekson se asnjë operator ekonomik nuk ka të drejtë të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose ekzekutim të kontratës, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj është shpallur fajtorë nga ndonjë gjykatë apo organ kompetent gjatë 10 viteve të kaluara.

Po ashtu, Udhëzuesi nr. 001/2023 për prokurim publik në pikën (j) thekson se kërkesat e pranueshmërisë (përveq deklaratës nën betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin AK ka për qëllim ta shpërblej me kontratë para nënshkrimit të saj. Afati kohor për dorëzimin e vërtetimeve - dokumenteve të cekura është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit për dhënie të kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.

Në pesë (5) raste² (katër raste të QKTGJK dhe një rast të IKSHPK) kontratave të nëshkruara kemi vërejtur se menaxheri i prokurimit në dosjen e tenderit nuk i kishte kërkuar dëshmitë/certifikatën mbi dënimet penale për drejtuesin/ menaxherin e kompanisë apo ndonjë drejtor të saj, por ato ishin kërkuar vetëm për Kompaninë, e që kjo nuk është në përputhje të plotë me nenin 65 të LPP-së.

Mos zbatimi i kërkesave ligjore përveç që tregojnë për një anashkalim nga Ministria mund të sjellë edhe deri tek shpërblimi me kontratë të OE që drejtuesit e tyre kishin qenë të dënuar nga ndonjë gjykatë kompetente në periudhën 10 vjeçare.

Çështja 5 - Mangësi gjatë procesit të vlerësimit të tenderimit

Neni 69 i LPP-së thekson se autoriteti kontraktues mund t'u kërkojë operatorëve ekonomik të ofrojnë dëshmi të arsyeshme që tregojnë se ata posedojnë kualifikimet minimale teknike dhe profesionale të specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin e kontratës. Po ashtu, rregullorja rr. 001/2022 për prokurim publik në nenin 40 përcaktonë parimet dhe kriteret që duhet të ndiqen gjatë ekzaminimit, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Bazuar në kontrollet e kryera të pajtueshmërisë identifikuaam se:

2 "Renovim gjeneral të objektit ekzistues - Transfuzionit të gjakut", "Furnizimi me Qese të gjakut", "Furnizim me Mikrokartela dhe Serume për grupe të gjakut", "Furnizim me pajisje laboratorike"-IKSHPK dhe , dhe "Furnizim me Kite për Multiplex RT PCR"

Te kontrata e QKTGJ-së “Renovimi gjeneral të objektit ekzistues Njësia Regjionale Gjilan dhe renovim të kufizuar të hapësirave ekzistuese Prizren” me vlerë 229,959€ gjatë ekzekutimit të punëve ishte identifikuar një gabim në kontratë ku vlera e disa pozicioneve nuk kishte qenë e përfshirë në vlerën totale të kontratës. Vlera e këtij gabimi ishte përtej vlerës së kontratës për 11,076€. Komisioni i Vlerësimit, nuk e kishte vërejtur fare këtë gabim gjatë procesit të vlerësimit, përkundër që një nga obligimet primare të komisionit është të sigurohet për vlerën e saktë të ofertës financiare e që nuk është në pajtueshmëri me nenin 40.6 të rregullores 001/2022. Po ashtu, zyrtari përgjegjës i prokurimit kishte bërë amandamentimin e kësaj kontrate për këtë vlerë pa aprovimin e ZKA.

Shkaku kryesor i këtyre mangësive ishte mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme dhe mungesa e kujdesit të duhur gjatë procesit të vlerësimit dhe dhënies së kontratës. Nëse nuk bëhet një vlerësim i saktë i ofertave dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara, ka rrezik të lidhjes së kontratës jo të saktë dhe me efekt negative financiar për Ministrinë.

3.3. Menaxhimi dhe monitorimi i kontratave

Ky aktivitet përfshinë hapat që Autoriteti kontraktues dhe Operatori ekonomik duhet t'i ndërmarrin bashkarisht për përmbushjen e kontratës.

Një menaxhim i mirë i kontratave siguron që të gjitha detyrimet dhe kushtet e kontratës të respektohen, duke minimizuar riskun dhe duke siguruar që të gjitha palët përmbushin detyrimet e tyre. Monitorimi i kontratave siguron që të gjitha afatet dhe kushtet e kontratës të përmbushen dhe që çdo ndryshim apo çështje e papritur të trajtohet në mënyrë efektive.

Çështja 6 - Vonesë në përmbushjen e aneks kontratës / kontratës

Rregullorja Nr. 001/2022 për prokurimin publik në nenin 10 pikën (b) specifikon se Njësia e Kërkesës, e cila është iniciues e kërkesës për prokurim, për secilin aktivitet të prokurimit, përveç tjerash ka përgjegjësi të përgatitë/propozon detyrën projektuese, projektin, specifikime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Paralogarinë. Po ashtu, sipas kushteve të veçanta të kontratës parashihet afati i përfundimit të punimeve. Ne identifikuam se:

- Ministria kishte lidhur një aneks kontratë përmes procedurës së negociuar të prokurimit për hartimin e projektit “Adaptimi i projektit të spitalit Covid-19 në Klinikën Emergjente” me shumë prej 18,667. Projekti kryesorë ishte hartuar nga po i njëjti operator ekonomik në vitin 2020. Bazuar në nevojat e arsyeshme për adaptimin e projektit MSh me 07.04.2023 kishte lidhur Aneks kontratë me afat përfundimi prej 30 ditësh.
- Aneks kontrata nuk ishte përmbushur në afatin e paraparë pasi që ekipi nga QKUK kishte ndryshuar kërkesat dhe detyrat për hartimin e projektit. Si rezultat i kësaj OE kishte kërkuar afat shtese dy herë. Amandamenti i parë për zgjatje të afatit të kontratës është bërë me 16.07.2023 dhe amendamenti i dytë 17.10.2023. Projekti ishte hartuar dhe pranuar me 21.11.2023, me një vonesë prej mbi 5 muaj; dhe

- Kontrata për “Renovimi gjeneral të objektit ekzistues Njësia Regjionale Gjilan dhe renovim të kufizuar të hapësirave ekzistuese Prizren” kishte vonesa në realizim për më shumë se 3 muaj pasi që sipas kushteve të kontratës do të duhej të përfundonte për 79 ditë (Kontrata ishte lidhur me datë 19.07.2023). Deri në muajin mars 2024 sa ishim në auditim nuk ishte përfunduar ende kjo kontratë.

Shkak i vonesës të aneks kontratës ishte mos marrja me prioritetit i afateve nga ekipet mjekësore që e kanë ndihmuar kompaninë projektuese në adaptimin e projektit. Arsyetimi i ekipit mjekësor ishte nevoja për kohë më të gjatë për ri dizajnimin e detyrave projektuese dhe kompleksitetit të reparteve mjekësore që duhet ti plotesojë projekti. Si pasojë e vonesave për përfundimin/adaptimin e projektit, Ministria nuk kishte mundur të tenderoj projektin për ndërtimin e Klinikës Emergjente në QKUK.

Përderisa te kontrata e renovimit gjatë procesit të punës në terren kishte mospërputhje në mes projektit dhe gjendjes reale në terren dhe është kërkuar një analizë tekniko financiare nga punëkryesi për eliminimin e këtyre pengesave, dhe kjo kishte ndikuar në mos përmbushje të kontratës sipas planit dinamik. Vonesa në përmbushjen e kontratave ndikon në mos arritjen e objektivave por edhe bartjen e obligimeve financiare për vitin e ardhshëm.

Çështja 7 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së e-Prokurimit

Funksionet e menaxherit të kontratës sipas paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullorës 001/2022 për prokurimin publik kërkojnë që për secilën kontratë “Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”. Bazuar në kontrollet e pajtueshmërisë të kryera identifikua se:

- Në tri kontrata të QKTGJK-së “Furnizim me mikrokartela dhe serume për grupe të gjakut” me vlerë 689,913€, “Renovimi gjeneral i objektit ekzistues - Transfuzioni i gjakut njësia Gjilan dhe Prizren” me vlerë 229,959€ dhe “Furnizim me qese të gjakut” me vlerë 962,258€) vërejtëm se menaxhimi i tyre nuk ishte bërë përmes platformës/modulit e - Prokurimi nga menaxheri i kontratës e që kjo nuk është pajtim me paragrafi 70.24. pika (f) të Rregullorës 001/2022. Menaxhimi i kontratave përmes këti moduli ka për qëllim të mbajë të informuar, azhurnuar dhe arkivuar mbarëvajtjen e një kontrate; dhe
- Te kontrata “Avancimin i paisjeve të rrjetit SISH në sektorin e shëndetësisë” në vlerë 498,758€, operatori ekonomik edhe pas furnizimit të pajisjeve, sipas kushteve të kontratës ishte përgjegjës për liferimin dhe montimin e pajisjeve në institucione shëndetësore pasi ato të konfigurohen nga AK. Për këtë pjesë menaxheri i kontratës nuk kishte vendosur ndonjë informatë në modulën e-prokurimi edhe pse ai vazhdonte të jetë menaxher i kontratës.

Procesi i menaxhimit të kontratave nuk ishte plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore pasi disa nga kontratat e ekzaminuara nuk menaxhoheshin përmes platformës elektronike. Kjo ka ndodhur si rezultat i mos njohurive të menaxherëve të kontratave lidhur me përdorimin e sistemit e Prokurimi dhe mungesës së trajnimit për ta.

Anashkalimi i modulit e-Prokurimi për menaxhimin e kontratave parandalon mundësitë që menaxhmenti të merr informata të mjaftueshme, në kohën e duhur në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

4. Konkluzionet

Bazuar në gjetjet e prezantuara në raport mund të konkludojmë se:

4.1. Sa i përket nënprocesit “Planifikimi i prokurimit”, vendimet dhe veprimet e Ministrisë të ndërmarra për periudhën e audituar nuk ishin në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse si më poshtë:

- Ministria nuk ka arritur që një numër të rëndësishëm të proceseve të prokurimit që ishin planifikuar dhe inicuar t’i përfundojë me kontrata të nënshkruara. Përgatitjet jo të duhura në fazat fillestare përfshirë mos hulumtimin e tregut, ndarjen e aktiviteteteve në shumë lloje, përshtatje të specifikimeve teknike dhe mangësitë tjera në proceset e tenderimit ishin faktorët kryesor që proceset të rezultojnë të pasuksesshme. Realizimi i ulët i planit të prokurimit kishte një ndikim të theksuar edhe në nivelin e shpenzimeve për projekte kapitale dhe furnizimeve me paisje mjekësore e barna (niveli ishte nën 50% të buxhetit të Ministrisë).
- Transparenca e proceseve përmes njoftimit paraprak nuk ishte aplikuar në të gjitha rastet. Mungesa e njoftimit paraprak ulë transparencën për OE-të që të njoftohen dhe përgatiten me kohë për prokurimet e mundshme.

4.2. Sa i përket nënprocesit “Procedurat e tenderimit”, vendimet dhe veprimet e Ministrisë të ndërmarra në periudhën e audituar nuk ishin në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse si më poshtë:

- Shmangiet e evidentuara në fazën e zhvillimit të aktiviteteteve të prokurimit tregojnë nevojën që kontrollet nga menaxhmenti të ushtrohen në kohën e duhur. Mungesa e analizave me kohë, para procesit të tenderimit dhe kontrollet e dobëta gjatë procesit duke mos vepruar në fazat e hershme të tenderimit, ka rezultuar në refuzim të nënshkrimit të kontratave nga menaxhmenti. Kjo situatë ka ndikuar që proceset të ritenderohen dhe Ministria të mos i arrijë objektivat e saj në vitin aktual. Pasojat e mos realizimit të këtyre aktiviteteteve kishin efekt në funksionimin e shërbimeve shëndetësore.
- Mangësi tjera në tenderim ishte edhe fakti që Komisionet e vlerësimit në raste të caktuara nuk kishin arritur të identifikojnë gabimet në përlllogaritje të vlerës së ofertës dhe këto gabime nuk u identifikuan as nga menaxheri i prokurimit dhe kjo rezultoi me një amandamentim të kontratës dhe kosto shtesë. Të gjitha këto mangësi mund të kenë efekt edhe në cilësinë e proceseve por edhe gjatë përmbushjes së kontratave.

4.3. Sa i përket nënprocesit “Menaxhimi i kontratës”, vendimet dhe veprimet e Ministrisë të ndërmarra në periudhën e audituar nuk ishin në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të LPP-së dhe akteve nënligjore përkatëse si më poshtë:

Procesi i monitorimit të kontratave ishte ballafaquar me sfida si vonesa në përmbushjen e kontratave, dhe mos aplikim të platformës e-Prokurimi për menaxhim të kontratave. Po ashtu, vonesat në hartimin përfundimtar të projektit kishte ndikuar direkt në shtyrjen e afatit për realizimin e projektit të Klinikës Emergjente në QKUK një projekt i rëndësishëm dhe rrjedhimisht edhe fondet kishin mbetur të pashpenzuara për këtë vit.

5. Rekomandimet

Me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuar dhe për të siguruar mbarëvajtje të proceseve nga faza e planifikimit e deri te përmbushja e kontratave dhe duke u bazuar në mangësitë e identifikuar me këtë auditim ne rekomandojmë si në vijim. Ministri duhet të siguroj që:

1. Para inicimit të aktiviteteve të prokurimit menaxheri i prokurimit në bashkëpunim të ngushtë me njësinë kërkuese duhet të sigurojnë hulumtimin e çmimeve të tregut dhe që vlera e parashikuar të jetë sa më e përafërt me çmimet e tregut për të shmangur dështimin e procesit të prokurimit si rezultat i mungesës së mjeteve apo mungesës së interesimit të operatorëve për të ofertuar.
2. Menaxheri i prokurimit në koordinim me njësinë kërkuese duhet t'i përgatisin specifikat teknike jo favorizuese dhe të shmangin kriteret e larta dhe kufizuese. Aktivitetet e prokurimit për projektet kapitale duhet të jenë të përcjella me projekte ekzekutive-studime të fizibilitetit që janë me cilësi dhe në kohën e duhur. Po ashtu, në të gjitha rastet të përgatiten dhe publikohen njoftimet indikative, si parakusht për transparencë ndaj OE dhe përmirësimin e konkurrencës së tregut.
3. Një vlerësim të detajuar të shkaqeve dhe rrethanave që kanë sjellë deri te mos nënshkrimi i kontratave në fund të procesit nga menaxhmenti. Kontrollat e proceseve të prokurimit duhet të vendosen në faza të hershme në mënyrë që të parandalohet dështimi për nënshkrimin e kontratave.
4. Ministri duhet të sigurohet nga menaxheri i prokurimit se kriteret në dosje janë plotësisht në harmoni me rregullat e prokurimit. Gjatë proceseve të vlerësimit të ofertave komisionet e vlerësimit duhet të tregojnë nivel të lartë të kujdesit për të gjitha kriteret në dosje dhe të parandalojnë gabimet në përllogaritje të cilat mund ti kenë bërë ofertuesit me ose pa qëllim.
5. Ministri duhet të sigurohet përmes menaxherëve të kontratave se kontratat po përmbushen sipas afateve të parapara duke aplikuar edhe penalet kur ato nuk realizohen sipas afateve. Po ashtu, duhet të organizohen trajnime për menaxherët e kontratave në mënyrë që për menaxhimin e kontratave të aplikohet platforma e e-prokurimit me qëllim të mbikqyrjes më të lehtë nga menaxhmenti apo përdoruesit tjerë të mundshëm

Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS - VLADA E KOSOVËS - Vlada KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVSTVA - MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinice Org. Unit	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	05-5046
Nr. faqeve Br. stranica No. pages	- 1 -
Data:	28/06/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – Ured Generalnog Sekretara –Office of the General Secretary

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të “Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave” të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrësë, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pajtueshmërisë “Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave” të Ministrisë së Shëndetësisë, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe komentet e dërguara të reflektohen në raportin final.
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

Data: 28 Qershor 2024, Prishtinë



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës